

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve G.M. nga fshati B., K. P. dhe I.A. nga fshati M., Komuna e P., për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare apo i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6131/16 të dt. 23.03.2017, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.22.02.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Ilir Morina dhe të akuzuarve G.M. dhe I.A., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 27.02.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **G.M.**, nga i ati R. dhe nëna H., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B. ku edhe jeton, me nr. personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. **I.A.**, nga i ati F. dhe nëna F., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin M. ku edhe jeton, me nr. personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

S e p s e :

Me datën 05.10.2016, rreth orës 13:00, në afërsi të Pikëkalimit kufitar Kosovë-Serbi, në vendin e quajtur kërrshi i Uglarit, përkatësisht në zonen e përgjegjësis, në kordinaten 34 EN 09210-73510, të pandehurit kanë kaluar pa autorizim kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës ashtu që me qëllim të hyrjes në territorin e Kosovës kanë kaluar kufirin duke bartur dru, me traktor të tipit Rakovic 65, ngjyrë e kaltër, me motor sharrë të tipit Husqvarna-365, në territorin e Kosovës me ç`rast kanë dëpërtuar në territorin e Kosovës në vendkalimin e paautorizuar kufitar.

Me këtë secili veç e veç kanë kryer veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare apo i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 17, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 146 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 116, 365, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, i

G J Y K O N

Të akuzuarit **G. (R.) M.** dhe **I. (F.) A.**, me **dënim me kusht**, ashtu që iu shqipton dënim me **burg në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit **brenda afatit prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejn vepër të re penale.

Detyrohen të akuzuarit e lartcekur që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajnë **secili veç e veç** shumën prej **20.00€ (njëzetë euro)**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej **30.00€ (tridhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet Policia e Kosovës-Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare “Veriu” në Lluzhan që mjetet e konfiskuara: **sharr-motorr Husqavarna-365 dhe qelsi ndezës i traktorit**, ti kthehen të pandehurit-pronarit G. M., pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.6131/16 të dt. 23.03.2017, kundër të akuzuarve G.M. nga fshati B., K. P. dhe I.A. nga fshati M., Komuna e P., për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare apo i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 22.02.2018, gjatë të cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Ilir morina nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të akuzuarit G.M. dhe I.A.

I akuzuari G.M. deklaroi: se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëritet.

I akuzuari I.A. deklaroi: se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëritet.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari dha mendimin duke deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase është bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar,

andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare apo i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka të njëjtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit nr.05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi kthimin e sendeve është marrë konform nenit 116 të KPPRK-së, pasi që nuk ka bazë ligjore për konfiskimin e tyre, meqenëse nuk kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.404/17, datë: 27.02.2018

Sekretarja juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.